

Nr. 6196 Prot.

Ballsh, më 26.12.2024

VENDIM

Nr 68 Datë 24/12/2024

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2026-2028 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2026**

Këshilli Bashkiak Mallakastër në mbledhjen e tij të datë 24.12.2024 pasi u njoh me materialin e përgatitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Çështjeve Sociale për kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor 2026", në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, neni 9, neni 41, neni 54, neni 64 gërma "c" dhe Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33,:

VENDOSI:

1. Të miratoj kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Mallakastër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

NEXHMI SULAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

**KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 DHE BUXHETIT
VJETOR 2026**

Nr	Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Afati
1	Paraqitja për shqyrtim e miratim të Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesëm të të Ardhurave	Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale	31 Janar 2025
2	Miratim nga Këshilli Bashkiak i Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesëm të të Ardhurave .	Këshilli i Bashkisë	01 Mars 2025
3	Përgatitja e tavanëve të shpenzimeve të PBA-së 2026-2028 nivel programi. Diskutimi në takimin e GMS	GMS dhe EMP	10 Mars 2025
4	Miratimi i tavanëve të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm PBA 2026-2028	Këshilli i Bashkisë	15 Mars 2025
5	Përgatitja dhe miratimi i udhëzimit të përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit Vjetor.	Këshilli i Bashkisë (Dr.Ekonomike ,GMS , EMP)	10 Prill 2025
6	Plotësimi i kërkesave buxhetore të konsoliduara për çdo program dhe kërkesave shtesë sipas programeve nga drejtuesit e EMP-ve.	EMP-të dhe Drejtoritë	05 Maj 2025
7	Vlerësimi dhe miratimi nga GMS-ja i kërkesave buxhetore.	GMS dhe EMP	15 Maj 2025
8	Hartimi i draft-dokumentit të PBA 2026-2028 Diskutimi në takimin e GMS. Dërgimi në MF i draft PBA-së.	Kryetari i Bashkisë GMS	01 Qershor 2025
9	Shqyrtimi dhe miratimi nga këshilli Bashkiak i draft PBA-së , duke u njohur edhe me rekomandimet e MF.	Këshilli Bashkiak	30 Qershor 2025
10	Dërgimi me shkrim dhe elektronikisht i PBA-së së miratuar nga këshilli në MF.	Kryetari i Bashkisë GMS	30 Qershor 2025

11	Publikimi i dokumentit të PBA-së të miratur.	Kryetari i Bashkisë GMS	05 Korrik 202025
12	Përgatitja e udhëzimit për përgatitjes e Buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarjen tek Njësitë Shpenzuese : a.tavanet përfituese b.afatet e përgatitjes së kërkesës të rishikimit të PBA-së 2026-2028.	Kryetari i Bashkisë GMS	25 Korrik 2025
13	Përgatitja e projektit të rishikuar të PBA-së 2026-2028. Organizimi i seancave dëgjimore me komunitetin (Nj. Administrative , Lagjet e Qytetit, Grupet e interesit, shoqëria civile). Hartimi i planit te masave dhe veprimit për organizimin e dëgjesave publike për PBA-në .	Kryetari i Bashkisë GMS	Gusht-Shtator 2025
14	Miratimi i PBA të rishikuar në Këshillin Bashkiak Njohja e Këshillit me rekomandimet e dhëna nga MF.	Këshilli Bashkiak	15 Shtator 2025
15	Zhvillimi i seancave të konsultimit dhe reflektimi i sugjerimeve në dokumentin final te PBA-së.	Kryetari i Bashkisë GMS	5 Tetor 2025
16	Pas miratimit të PBA-së të rishikuar përgatitja e Projekt Buxhetit Vjetor , parashikimi për çdo zë të ardhure dhe shpenzimi: - Për çdo program. - Për çdo Njësi shpenzuese.	Drejtoritë e Bashkisë	30 Nëntor 2025
17	Miratimi nga Këshilli Bashkiak i Buxhetit Vjetor dhe i PBA përfundimtare 2026-2028	Këshilli Bashkiak	25 Dhjetor 2025
18	Dërgimi i një kopjeje të Buxhetit Vjetor 2026 dhe i PBA-së përfundimtare 2026-2028, në Ministrinë e Financave.	Sekretari GMS	5 ditë nga data e miratimit
19	Publikimi i Buxhetit Vjetor dhe i PBA përfundimtare së bashku me dokumentacioni shoqërues: - Në faqen zyrtare të Bashkisë - Buletini e Njoftimeve Publike	Spektori i Burimeve Njerëzore	5 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak

KRYETAR

NEXHMI SULAJ

